-Për punimet e gipsit nga Ak është kërkuar që të punësuar një numër minimal prej 5 (pese) specialist për punime gipsi. Punime të tilla duhet të realizohen me saktësi nga punëtorë të kualifikuar. Projekti i parashikuar të zbatohet nëpërmjet kësaj procedure parashikon realizime të punimeve të ndertimit të mureve me kartonxhes etj. Konkretisht për kryerjen e këtyre punimeve në mbështetje të Manualit të ndertimit miratuar me Vendim nr.629, date 15.07.2015 (*Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018 duhen gjithësej 1,286 ore pune ose 160 dite pune 8 orarshe. Afati I punimeve është 30 dite)*

-Për punimet e dritareve dhe dyerve nga Ak është kërkuar që të punësuar një numër minimal prej 4 (kater) specialist për punime durale. Punime të tilla duhet të realizohen me saktësi nga punëtorë të kualifikuar. Projekti i parashikuar të zbatohet nëpërmjet kësaj procedure parashikon realizime të punimeve të vendosjeve të dyerve të brendshme, dyerve të blinduara, vetratave etj. Konkretisht për kryerjen e këtyre punimeve në mbështetje të Manualit të ndertimit miratuar me Vendim nr.629, date 15.07.2015 (*Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018 duhen gjithësej 5,452 ore pune ose*

681 dite pune 8 orarshe. Afati I punimeve eshte 5 muaj Ky numër është shumë minimal në raport me vëllimin e punës.

-Punimet e muraturës në objektin që ndërtohet parashikojnë ndërtimin e të gjithë mureve në vëllimet që ndërtohen dhe në vëllimin që rikonstruktohet, duke qenë se hapsirat e brendshme në vëllimin që rikonstruktohet do të rikonceptohen tërësisht. Vëllimi i këtyre punimeve është shumë i madh dhe realizimi i tyre duhet të kryehtë nga punëtorë të kualifikuar. Muratorët, sipas Listës Shqiptare të Profesioneve, realizojnë detyra të tilla si: Përzgjedhin materialet e nevojshme dhe veglat e punës para fillimit të procesit të punës, respektojnë me rigorozitet radhën e kryerjes së çdo procesi pune sipas orientimit të dhënë në objekt, bëjnë përgatitjen e sasisë së nevojshme të llacit për procesin ditor të punës, duke respektuar porcionet e duhura të materialeve përbërëse, bëjnë breza përforcues betoni në gjysmën e lartësisë së murit ose sipas specifikimit në projekt, kontrollojnë nëse muret janë të lidhur midis tyre horizontalisht dhe vertikalisht duke garantuar kështu qëndrueshmërinë e tyre, ndërtojnë soletat, vendosin arkitrarët e dyerve dhe dritareve, vendosin kondrakasat e dyerve dhe dritareve, nëse ka të tilla të parashikuara në projekt, bëjnë mbushjen me llac të mureve në nivelin e fashove me dorë ose me pompë në varësi të materialit të përcaktuar nga drejtuesi teknik në objekt, përgatitin materialin e nevojshëm për tavane me gips apo për tavane të varura zbukurues duke bërë matjet dhe prerjet e duhura, bëjnë stukime apo riparimet e duhura të objekteve të ndryshme, bëjnë kontrollin përfundimtar të punimeve, duke u siguruar që gjithçka është sipas përshkrimit në projekt etj. Konkretisht per kryerjen e ketyre punimeve ne mbeshtetje te Manualit te ndertimit miratuar me Vendim nr.629, date 15.07.2015 (*Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018 duhen gjithesej 12,606 ore pune ose 1,576 dite pune 8 orarshe. Afati I punimeve eshte 7 muaj dhe kemi qe per realizimin ne aftat teketyre punimve duhen 8 punonjes të specialiste muratorë/suvatues.* Kërkesa për 10 (dhjete) muratorë/suvatues është minimale në raport me vëllimin e punës.

-Projekti i zbatimit, objekt i kësaj procedure prokurimi parashikon ndër të tjera realizimin e punimeve të hidroizilimit dhe punimet e çative. Këtu përfshihen të gjitha punimet dhe shtresat e lidhura me hidroizilimin për themelet, muret anësore të tyre, ambientet në kontakte me ujin si tualetet etj, hidroizolimin e tarracave. Konkretisht per kryerjen e ketyre punimeve ne mbeshtetje te Manualit te ndertimit miratuar me Vendim nr.629, date 15.07.2015 .Për realizimin e punimeve të tilla në të gjithë vëllimet e objektit, në të cilët në periudha të gjata do të punohet paralelisht, kërkesa që OE të ketë të punësuar të paktën 4 (kater) hidroizolues është kërkesë minimale në raport me vëllimin e madh të punës.

-Për punimet e bojatisjeve të brendshme dhe të jashtme të të gjithë mureve dhe tavanëve AK ka kërkuar që OE të ketë të punësuar minimalisht 6 (gjashte) bojaxhinj. Konkretisht per kryerjen e ketyre punimeve ne mbeshtetje te Manualit te ndertimit miratuar me Vendim nr.629, date 15.07.2015 (*Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018 duhen gjithesej 7,672 ore pune ose 959 dite pune 8 orarshe. Afati I punimeve eshte 3 muaj dhe kemi qe per realizimin ne aftat teketyre punimve duhen 10 punonjes nga te cilet punonjes të specializuar pra per kete rast kerkohen 6 bojaxhinj.* Ky numër është shumë minimal në raport me vëllimin e madh të punës, në të cilët në periudha të gjata do të punohet paralelisht.

-Referuar Listës Shqiptare të Profesioneve, shtruesi i pllakave (pllaka shtruesi) dhe të tjerë që lidhen me to instalon, mirëmban dhe riparon parkete dhe lloje të tjera të dyshemeve ose mbulojnë dyshemetë, muret ose sipërfaqet e tjera me pllaka ose panele mozaikësh për qëllime dekorimi ose të tjera. Punimet e parashikuara në këtë projekt parashikojnë shtrimin e të gjitha dyshemeve të

kateve, shtrimin e sipërfaqeve të shkëlqime të shkallëve, shtrimin me pllaka të mureve të tualeteve etj. Këto punime në preventiv përfshijnë sipërfaqe të mëdha. Për realizimin e tyre AK ka kërkuar që OE të ketë të punësuar një numër minimal prej 7 (shtate) pllakashtruesish. Konkretisht për kryerjen e këtyre punimeve në mbështetje të Manualit të ndertimit miratuar me Vendim nr.629, date 15.07.2015 (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018 duhen gjithësej 15,774 ore pune ose 1,972 dite pune 8 orarshe. Afati I punimeve është 9 muaj dhe kemi që për realizimin në afat të këtyre punimeve duhen 7 punonjës të specializuar për shtrues pllakash. Ky numër është shumë minimal në raport me vëllimin e madh të punës, për realizimin e të tilla punimeve në të gjithë vëllimet e objektit, në të cilët në periudha të gjata do të punohet paralelisht.

Percaktimi i numrit të punonjësve dhe profesionet është bazuar mbi zerat dhe volumet e punës si dhe afateve për perfundimin e punimeve, në mbështetje të Manualit të ndertimit miratuar me Vendim nr.629, date 15.07.2015 (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në kater elementet e struktures së kostos (material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore

2.3.11 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës :

<i>Nr</i>	<i>Lloji i Makinerive</i>	<i>Statusi</i>	<i>Sasia</i>
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 15 - 20 Ton	<i>në pronësi ose me qira</i>	3
2	Kamioncine me kapacitet mbajtes deri 1.5 Ton	<i>në pronësi ose me qira</i>	2
3	Kamioncine me kosh	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
4	Autobetoniere	<i>në pronësi ose me qira</i>	3
5	Autopompe Betoni	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
6	Fadrom me goma me kove para mbrapa	<i>në pronësi ose me qira</i>	2
7	Minifadrom	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
8	Minieskavator	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
9	Autobot uji	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
10	Asfaltoshtruese	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
11	Auto bitumatrice	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
12	Rrul me cilindër - cilindër kapaciteti mbi 7 ton	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
13	Rrul gome-hekur mbi 7 ton	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
14	Matrapik eskavatori	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
15	Vibrator betoni	<i>në pronësi ose me qira</i>	4
16	Kompaktor ngjeshes	<i>në pronësi ose me qira</i>	2
17	Matrapik	<i>në pronësi ose me qira</i>	2
18	Betoniere kantieri	<i>në pronësi ose me qira</i>	5
19	Nivelues betoni helikopter	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
20	Kompresor	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
21	Kontenier ndertimi stacionar	<i>në pronësi ose me qira</i>	1

22	Skeleri fasade	<i>në pronësi ose me qira</i>	1000 m ²
23	Betonforma	<i>në pronësi ose me qira</i>	100 m ³
24	Gjenerator minimumi 5 KVA	<i>në pronësi ose me qira</i>	2
25	Depozite 2000-5000 lit	<i>në pronësi ose me qira</i>	5
26	Motopompe uji	<i>në pronësi ose me qira</i>	2
27	Motosaldatrice	<i>në pronësi ose me qira</i>	2
28	Vinc Kulle (Lartësia mbi 10 m , Gjatsia e Krahut mbi 40 m , Peshmbajtja maksimale mbi 2.5 ton , Peshmbajtja ne maje (40 m) mbi 1.3 ton)	<i>në pronësi ose me qira</i>	1

<i>Nr</i>	<i>Mjete mbrojtëse</i>	<i>Statusi</i>	<i>Sasia</i>
1	Kokore	<i>në pronësi ose me qira</i>	80 cope
2	Jelek	<i>në pronësi ose me qira</i>	80 cope
3	Tabela Sigurimi Teknik	<i>në pronësi ose me qira</i>	30 cope
4	Fikse Zjarri	<i>në pronësi ose me qira</i>	5 cope
5	Kuti Ndihme e shpejt	<i>në pronësi ose me qira</i>	5 cope

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit: - certifikatën e pronësisë, -leja e qarkullimit, -certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin dhe fotot përkatëse;
- Ndersa për mjetet të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata notoriale e qirase dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve;
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndersa për mjetet të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve;
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara në procedurë të shpallura fitues.

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuesë ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gërmën i) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të

Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër është kërkuar në funksion të kryerjes së zerave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varesi të volumeve të punimeve përcakton se ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesi i mundshëm të vërtetohet se zotëron kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim:

2.4.1 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë të përcaktuara si më poshtë:

- **Certifikatë ISO 9001:2015 - Certifikim për menaxhimin e cilësisë ose ekuivalente** (e vlefshme për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarte evropiane e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qenë se kjo lloj certifikate ISO-mund të ketë evoluar ndër vite do të pranohet edhe çdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kesaj ISO; *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE*
- **Certifikatë ISO 14001:2015 - Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit ose ekuivalente** (e vlefshme për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarte evropiane, e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qenë se kjo lloj certifikate ISO mund të ketë evoluar ndër vite do të pranohet edhe çdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kesaj ISO. *Në rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE.*

- **Certifikatë ISO 45001:2018 - Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë ose ekuivalente**, e vlefshme për gjithë periudhën e realizimit të kontratës) për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarde evropiane, e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qënë se kjo lloj certifikate ISO mund të ketë evluar ndër vite do të pranohet edhe çdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kesaj ISO. Në rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE.

(Të gjitha këto dokumenta Certifikata ISO duhet të jenë të përkthyer dhe noterizuar).

Argumentim: Argumentimi 2.4 : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të Ligjit 162/2020 të Prokurimit Publik, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Konkretisht :

- **Kërkesa Lidhur me çertifikimin ISO 9001:2015 ose ekuivalent**, na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjëndje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mire të cilësisë. Përkatësisht kjo lloj ISO specifikon kërkesat për një sistem cilësor të menaxhimit të cilësisë, kur një organizatë:
 - duhet të dëshmojë kapacitetin për të siguruar vazhdimisht produktin që kënaq klientin dhe kërkesat staturore dhe normative të aplikueshme.
 - synon të përmirësojë kënaqjen e klientit, nëpërmjet aplikimit të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe garancisë të konformitetit me klientin dhe kërkesat staturore dhe normative të aplikueshme.

Me anë të kërkesës për paraqitjen e kesaj certifikate ose të përditësuar, AK kërkon të vërtetojë se OE ka kapacitetin për të garantuar konformitetin me kërkesat cilësore të tij.

- **Kërkesa Lidhur me çertifikimin ISO 45001:2018 ose ekuivalent**, është vendosur duke iu referuar natyrës dhe specifikës që mbart objekti i prokurimit që lidhet me procese pune ndërtimi. Rreziqet që lidhen me punën në kantier janë të shumta dhe janë shtjelluar në kriteret e mësipërme, si dhe në specifikimet teknike të projektit të zbatimit. Për këtë arsye, AK duhet të sigurohet se OE zotëron kapacitetet për menaxhimin, kontrollin dhe parandalimin e risqeve për sigurinë e jetës dhe shëndetit gjatë procesit të punës.

Paisja me këtë lloj certifikimi dëshmon se subjekti plotëson kërkesat e paraqitura nga ky standard për identifikimin, kontrollin dhe zvogëlimin e risqeve, të lidhura me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës.

- **Kërkesa Lidhur me çertifikimin ISO 14001:2015 ose ekuivalent**, na shërben pasi sikurse përcaktohet edhe në VNM e përgatitur nga projektuesi, zbatuesi i punimeve duhet të marrë parasysh një sërë masash për zbutjen e efekteve negative në mjedis, si rezultat i zbatimit të punimeve për përmbushjen e kësaj kontrate. Të gjitha punimet e parashikuara në këtë procedurë duhet të kryhen në përputhje me specifikimet dhe dokumentacionin teknik të përgatitur nga projektuesi, duke respektuar legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e mjedisit.

Nga sa më sipër AK ka kërkuar që OE të paraqesë certifikatën ISO 14001:2015 (ose ekuivalente) për të dëshmuar kapacitetin për të kryer punimet në përputhje me rekomandimet e VNM, në konformitet me legjislacionin mjedisor në fuqi dhe standardet shtetërore dhe ndërkombëtare të menaxhimit mjedisor.

2.4.2 Operatori Ekonomik duhet të disponojë:

a- Ne Pronesi / Kontrate Qeraje/ Kontrate Furnizimi, Fabrike prodhimi per Fino, Koll, Llacra etj te pajisura me (Leje mjedisore, QKL Kodi III.1.B dhe ISO 9001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit te Cilesise) e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontrates objekt i këtij prokurimi. Furnizusi te kete status aktiv ne QKB. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, dokumentat e mësipërme duhet ti paraqesë të pakten njeri nga anëtarët e grupit).

b- Ne Pronesi / Kontrate Qeraje/ Kontrate Shërbimi me nje laborator testimi të materialeve kryesore të ndertimit beton, hekur, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombetar ose nderkombetar sipas standarteve SSH EN 12390-3:2009, SSH EN 12350-2:2009 dhe SSH EN 12504-2:2012 e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontrates objekt i këtij prokurimi. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, dokumentat e mësipërme duhet ti paraqesë të pakten njeri nga anëtarët e grupit).

Argumentimi: Ne baze te nenit 77 te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe piken 8, te nenit 40, te VKM Nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", me ane te ketij kriteri AK gjykon se disponimi ne pronesi apo me qera i ketyre fabrikave eshte nje dokument i rendesishem, pasi pervec se tregon origjinen e mallrave qe kerkohen ne procedure, garanton se ofertuesi eshte i garantuar per ofrirnin tek Autoriteti Kontraktor te ketyre mallrave qe do te perdoren ne punimet e planifikuara. Kjo garanci lidhet njekohesisht edhe me treguesit cilesore te mallrave objekt prokurimi te cilat kerkohen qe te jene prodhuar ne perputhje me standardet dhe cilesite e kerkuara ne DST. Ky kriter eshte ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates dhe lidhet drejtperdrejte me aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine e OE ofertues per aftesite teknike. Kjo kerkese i sherben autoritetit kontraktor per njohjen e

mundesise se OE per permbushjen me sukses te kontrates pasi sasia e produkteve qe do te perdoren eshte e konsiderueshme.

2.4.3 Ne perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates , operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim /kontrate bashkepunimi nga prodhuesi / distributor , me të cilin prodhuesi / distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje / mallra në këtë procedurë prokurimi , si më poshtë:

- Materiale elektrike
- Materialet e sistemit te mbrojtjes kundra zjarrit (MNZ)
- Materialet hidraulike
- Materialet e rrjetit ngrohes (HVAC)
- Bojra
- Materiale hidroizoluese
- Materjale Shtresash Pllaka , Kollë
- Materjale Suvatimi dhe veshje
- Materiale gipsi
- Pllaka
- Materiale durale
- Ashensori
- Gaz Mjeksor

Në rast se do te paraqitet autorizim distributori operatori ekonomik ta vertetoj kete duke paraqitur kontratë premtimi, letër angazhimi / akt-marreveshje lidhur mes Kompanisë prodhuese dhe Distributorit të autorizuar, si dhe cdo dokumentacion tjetër ligjor të vlefshëm që provon lidhjen e distributorit të autorizuar me prodhuesin”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje dhe propocion me natyrën, objektin dhe volumin e kontratës objekt prokurimi. Duke marrë në konsideratë edhe natyrën e punimeve, zërat të cilat kanë volum maksimal të lëndës bazë dhe materialeve të kryerjes së punimeve. Kriteri i përcaktuar mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

Në këtë kontekst, referuar vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dokumentit te cituar nuk ka kufizuar konkurrencën, pasi një kriter i tillë nuk është diskriminues për operatorët ekonomikë. Për autoritetin është e rëndësishme që të sigurohet sherbim me “mall” sipas standarteve të kërkuara, specifikimeve teknike, e gjithashtu dokumentacioni i kërkuar për tu paraqitur është i parashikuar dhe brenda kuadrit ligjor të sipërcituar. Neni 40 pika 6 germa b) e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i jep mundësinë autoriteteve kontraktorë t’u kërkojnë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat

minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

2.4.4. Ne perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivin perkates për produktet e meposhtme duhet te paraqiten:

1. PUNIMET ELEKTRIKE

- Për materjalet elektrike Percjelles bakri izolim PVC , Kabell elektrik bakri FG7OR , Celes elektrik , Priza elektrike shuko , Panel elektrik , Automat magnetik termik , Ndriçues plafonier led 60x60 ,Ndriçues plafonier led , Tabele "EXIT" te ndriçuara llampe led , Ndriçues rrugor led , Paisje energjie UPS/3F-30kVA , Central Zjarri i Adresueshem i kompozuar , Sensor Optik Temperature , Sensor Optik Tymi , Buton per thirrje manuale i adresueshem , Sirene per brenda ndertese optike dhe akustike , NVR 32 Kanale, 16 PoE,4K, HDD 2x4TB SEAGATE, full HD , Kamera Bullet , Kamera Dome **duhet të paraqiten: Skedat teknike/kataloge te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar ose certifikata aprovimi/performance.**

2.PUNIME HIDRAULIKE

- Për materjalet hidraulike Minisaracineska 1/2" , Saracineska bronzi , Tuba dhe Rakorderi PP3 HTEM , Tuba te brinjezuar HDPE SN8 , Pompe per furnizimin me uje , Pompe per sistemin MNZ **duhet të paraqiten: Skedat teknike/kataloge te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar ose certifikata aprovimi/performance.**

3. PUNIME HVAC

- "Pompe Nxehtesie (Versioni ajer / uje Inverter, komplet me kitin hidraulik).Kapaciteti ftohes / ngrohes: 453 / 503 kW .Temp. te jashtme vere / dimer : 36°C / -2°C -Fuqia elektrike / tensioni / intensiteti /ushqimi : 210 kW / 400V / 351A / 3 F ~ 50Hz . Kit hidraulik (ene zgjerimi, pompe qarkullimi inverter, valvol, etj.)Sensor komplet. dhe mbrojtje atomatike kunder ngrirjes.Kompletuar me strukture metalike mbeshtetse me amortizator. ". **Duhet te paraqiten: Kataloget/ skedat teknike te shoqeruara me Certifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi.**
- "Kaldaje e ujit te ngrohte HVAC Karakteristikat Teknike :- Fuqia termike min/max : 468/720 kW, - Dimensioni tubi dergim / kthim : DN 100 / DN 100- Dimensioni i kanalit te tymit : Ø 340 mm- Presioni max: - 6 bar-Humbja ne shkarkimin e tymit: 4.5 mbarI kompletuar me valvola nderprerese, sigurie , shkarkimi, manometer, termometer,sensor elektronik etj. ". **Duhet te paraqiten: Kataloget/ skedat teknike te shoqeruara me Certifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi.**
- "Ene zgjerimi Karakteristikat Teknike:-Autokllave me membranë-Presioni max : 10 bar, - Kapaciteti 50 lit -De = 407 mm -H = 528 mm -Lidhjet: F Ø 3/4" **Duhet te paraqiten: Kataloget/ skedat teknike te shoqeruara me Certifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi.**

- "NJESI TRAJTIMI AJRI, RIKUPERATOR NXEHTESIE Seksioni i Rikuperimit te Nxehtesise Fryrja Derg/Rikthim: 1500m³/h , Renia Presioni: 120 Pa , Rendimenti : 55% , Fuqija Elektrike: 2x550Wat , Grupi filtrave: F7/G3 , Seksioni i Trajtimet te Ajrit (Baterite) , Kapacitetit Termik Ng: 7.5 kW , Kapaciteti Termik Ft: 6.8 kW , Kompletuar me gjithë elemntet e nevojshem per montim. Sidhe sistemin e kontrollit." **Duhet te paraqiten: Kataloget/ skedat teknike te shoqeruara me Certifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi.**
- Rezervuar per karburant, me bokaporte te fllaxhuar, me pusete furnizimi dhe me te gjitha lidhjet e duhura ,çertifikuar per presion te brendshem 1.0 bar.I kompletuar me te gjithë aksesoret :(me nivel mates elektrik, saraçineske bllokimi, tub i mbushjes,tub i dergimit, tub i ajrimit , etj). Me dalje nga poshte, me fileto 3"F. **Duhet te paraqiten: Kataloget/ skedat teknike te shoqeruara me Certifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi Dokumentin e testimit te lyerjes se jashtme , dokumenti i testimit hidrostatik certifikate kalibrimi ; certifikaten e inspektimit te materialit të perdorur.**

4. PUNIME BOJATISJE

- **Bojë Akrilike** produkti duhet te përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN ISO 16000-9 ose ekuivalente duhet te paraqiten:**Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente. Certifikim ku të vërtetohet se produkti eshte boje ekologjike.**
- **Boje Hidroplastike** ku të vërtetohet se produkti përmbush specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN ISO 16000-9:2006/AC:2007 ose ekuivalent . **Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente Certifikim ku të vërtetohet se produkti eshte boje ekologjike dhe antibakteriale.**
- **Bojë hidromat** të jetë me bazë rezinë vinilike, e cila shërben për përdorim të brendshëm, për sipërfaqe muresh apo tavanesh. **Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente.**
- **Bojë vaji** Boja të jetë me bazë rezine alkide e cila i jep produktit mbulim të madh dhe rezistencë ndaj agjentëve atmosferikë dhe e tretshme në ujë. Të jetë e përshtashme për sipërfaqe metalike dhe druri.**Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me Certifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi. Certifikim ku të vërtetohet se produkti eshte boje ekologjike.**

5. PUNIME SHITESASH

- **Hidroizolues** Material dykomponentesh me baze çimento dhe hidroizolues, elastik me funksion mbrojtës për terrace, themele, bodrume, etj. Produkti duhet te përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH EN 14891:2017 ose ekuivalente, lidhur me produktet e lëngshme të papërshkueshme nga uji. **Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente.**

- **Kolle Speciale Antilagështirë** Ngjitës thiksotropik, elastik, i gatshëm për përdorim, me bazë shpërndarjen ujore të estereve poliakrilike dhe shtesa të veçanta kategoria D2TE sipas EN 12004. (ose ekuivalente). Produkti duhet të përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin Shqiptar SSH EN 12004:2007 +A1:2012 **ose ekuivalente**. **Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me Certifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi.**
- **Pllakë shtrimi grez porcelanato**. Nuk duhet të jenë të lëmuara në mënyrë që të shmanget rrëshqitja. Duhet të jenë rezistente ndaj gërvishtjeve (kategoria 4) dhe të kenë koeficientin më të lartë të mundshëm kundër rrëshqitjes. **Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me Certifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi.**
- **Veshje me pllakë majolike**, Formati 30x60 cm x 10mm ose 60x60 (mbas kërkesës), Porcelain ,cilësi e parë. **Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me Certifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi.**

6.PUNIME SUVATIMI DHE VESHJE

- **Suva (Llac mbushës)** - Produkti duhet të përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN 998-1(ose ekuivalente).. Në rast se është produkt jo i gatshëm të deklarohet receptura përkatëse që vërteton se produkti përmbush specifikimet teknike te kerkuara edhe sipas SSH: EN 998-1(ose ekuivalente).. **Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente.**
- **Fino** Produkti duhet të përmbushë specifikimet teknike te kerkuara edhe në përputhje me Standardin SSH: EN 998-1(ose ekuivalente).. **Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente.**
- **Stuko patinimi** - Stukoja e patinimit të jetë material i cili realizon një veshje plastike (akrilike) për sipërfaqe të ndryshme të mureve, me efekt mbushës dhe maskues duke krijuar një shtresë të trashë, e cila mbulon dëmtimet e mundshme të shkaktuara në sipërfaqet e mureve dhe njëkohësisht e mbron nga agjentet atmosferikë. Produkti duhet të përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin Shqiptar SSH EN 998-1:2016 **ose ekuivalente** Pjesa 1: Llaç për suvatim dhe stukim ose ekuivalentin e tij. **Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente.**

7.PUNIME MURATURE

- **Polisteroli**. Produkti duhet të përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH EN 131631 **ose ekuivalente**. **Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente.**
- **Plakë gipsi për ambjete të brendshme** Pllakat e gipsit për ambjete të brendshme përdoren para së gjithash si veshje një shtresore në sistemet e mureve që nuk plotësojnë ndonjë kërkesë të veçantë. E përshtatshme për forma dhe distanca të ndryshme të montimit. Të ketë stabilitet të lartë edhe për konstruksionet me një veshje të vetme shtrese pllake. Përpunim të jetë i thjeshtë. Të ketë bymim dhe tkurrje e vogël si rezultat i ndryshimeve të

kushteve klimaterike. **Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me Certifikatë Konfirmimiti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi.**

7.MATERJALE DURAL

- **Materjale durale** . Produkti duhet te përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH EN 13830 ose ekuivalente. **Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar ose ekuivalente.**

8. ASHENSORI

- Ashensor sherbimi spitalor; hidraulik per transportin edhe te personave me aftesi te kufizuara dhe te shtreterve spitalor; me aftesi mbajtese 1600 kg; me kapacitet; me 5 ndalesa; **Duhet te paraqiten : Kataloget / skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmimiti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi , çertificate per ashensorët e personave sipas standartit SSH EN 81-20:2020 dhe direktives 2014/33/EU(ose ekuivalente) e leshuar nga organe te akredituara kombëtare ose ndërkombtare.**
- Ashensor sherbimi ; hidraulik per transportin edhe te personave me aftesi te kufizuara dhe te shtreterve spitalor; me aftesi mbajtese 1200 kg; me 5 ndalesa; **Duhet te paraqiten : Kataloget / skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmimiti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi , çertificate per ashensorët e personave sipas standartit SSH EN 81-20:2020 dhe direktives 2014/33/EU(ose ekuivalente) e leshuar nga organe te akredituara kombëtare ose ndërkombtare.**

9.GAZ MJEKSOR

- Certifiaktë ISO 13485:2016 ‘Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë së Aparateve Medicinale” të prodhuesit ose të distributorit të autorizuar të prodhuesit me objekt “ **Instalim mirembajtje te impianteve dhe sistemeve per perdorim dhe shperndarje te gazeve mjekesore, sistemet e vakumit dhe gazit anestezik**
- Certifikate 45001:2018 sistem menaxhimi i shendetit dhe cilesise ne pune me objekt “ **Instalim mirembajtje te impianteve dhe sistemeve per perdorim dhe shperndarje te gazeve mjekesore , sistemet e vakumit dhe gazit anestezik**
- Certifikate ISO 9001-2015 per sistemin e menaxhimit te cilesise me objekt “ **Instalim mirembajtje te impianteve dhe sistemeve per perdorim dhe shperndarje te gazeve mjekesore, sistemet e vakumit dhe gazit anestezik**
- **Paisjet mjekësore janë të autorizuar për tregtim në Republikën e Shqipërisë, duhet të paraqitet dokument lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve: Mjekësore Certifikatë Regjistrimi në përputhje me ligjin 89/2014 “Për paisjet mjekësore”**
- **Per te gjitha zerat ne preventiv te gazeve mjekesore duhet te paraqitet katalogu ku te jene te nenvizuara materialet e kerkuara**

- ❖ **Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

Argumentimi: Në bazë të nenit 4, nenit 36 si dhe nenit 79 pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe bazuar në nenin 44 pika 1, e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021. Ky kriter është vendosur që AK të ketë sigurinë që operatori ekonomik që do të ofertojë të jetë i pajisur me certifikatat e mësipërme, të lidhura me objektin e prokurimit, gjë që cila krijon bindjen dhe sigurinë të Autoritetit Kontraktor që ky Operator Ekonomik i zoteron kapacitetet teknike për realizimin me sukses të kontratës.

Në nenin 44 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave parashikohet se: “1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Kjo kërkesë është kërkuar që të sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm Teknik dhe plotëson specifikimet e kërkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësi e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kërkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm. Në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të verifikojë që specifikimet teknike të paisjeve të propozuara nga operatorët ekonomik plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: certifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilësisë ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara në Specifikimet teknike .

Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet/shërbimet që parashikohen të realizohen në preventive si dhe për shkak të interesit të lartë që ka objekti duhet të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane. Prandaj e gjerësojmë të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, që OE ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit.

Për të siguruar këtë gjë, por njëkohësisht dhe për të detyruar ofertuesit e mundshëm në zbatimin e këtyre standarteve ka parashikuar kërkesën e mësipërme vetëm për disa nga mallrat kryesorë me qëllim që do të përdoren në këtë objekt konkretisht OE duhet të japin dhe paraqesin në mënyrë të detajuar karakteristikat teknike të mallrave të përfshirë në dokumentat e tenderit, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga projektuesi.

Për këtë, ofertuesit duhet të deklarojnë produkte të pajisura me çertifikatë konformiteti CE/certifikate cilesie etj. Me anë të venies ne dispozicion ne fazen e ofertimit dokumentat si autorizim-marreveshje angazhimi, skeda teknike,certifikata cilesie, certifikata konformiteti,raporte testimi ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë prodhim sipas kerkesave te projektit. Plotësimi i kërkesës sipas pikës 9, garanton Autoritetin Kontraktor për cilësinë dhe standartet e larta ndërkombetare dhe te perditesuara sipas teknologjise se re dhe bashkekohore.

Gjithashtu ne përzgjedhjen e grup mallrave të mësipërme të cilat do të vendosen në objekt si edhe shërbejnë për ndërtimin e objektit, eshte marrë në konsideratë një test balancues dhe proporcional në përzgjedhjen e tyre. Kështu është vlerësuar se në përzgjedhjen e grup mallrave të mësipërme të cilat do të vendosen në objekt janë marrë në konsideratë 2 faktorë, volumi i tyre, duke marrë në konsideratë parashikimet e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ku parashikohet se Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese. Sa më sipër, materialet e sipërcituara zënë një peshë specifike në punimet që do të kryhen në objekt, ndaj kërkesa lidhur me to është në proporcion me natyrën dhe volumin e punimeve.

Ky kriter i marrë në konsideratë lidhet ngushtësisht me faktin se shumica e produkteve te mësipërme kanë bazë kimike dhe kanë /mund të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin e studenteve/pedagogeve etj. Akoma më tej vlerësojmë se kemi të bëjmë me një objekte arsimore ku përpueshmëria e cilësisë së materialeve të vendosura në objekt nuk duhet të sjellë pasojë shëndetësore në shëndetin e studentëve/pedagogeve etj, duhet të përmbushë nivelin ekologjik të kërkuar dhe duhet të jetë në përputhje me Standardet e Njohura në Republikën e Shqipërisë.

Kërkesa për dorëzimin e formatit të autorizimit të prodhuesit dhe katalogëve për produktet e sipërcituara është një kërkesë në përputhje dhe proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës dhe se i shërben qëllimit të autoritetit kontraktor, nuk krijon pengesa të dukshme ose të fshehura për ofertuesit si edhe nuk diskriminon midis operatorëve ekonomikë vendas dhe të huaj, pasi standartet e kërkuara është Standardi Shqiptar i cili është i harmonizuar me Standardin European. Gjithashtu, në përputhje dhe proporcion me vlerën dhe natyrën e kontratës dhe peshës sepcifike të secilës prej mallrave që do të vendosen në objekt atëherë është parashikuar që për një pjesë prej tyre të dorëzohen vetëm katalogjet ndërsa për mallrat dhe paisjet të cilat kanë një ndikim të veçantë në mjedis si edhe ndikim të veçantë në shëndetin qytetareve, krahas katalogjeve të prodhuesit është kërkuar edhe dorëzimi i raport testeve zyrtare të lëshuar nga laboratorë të akredituar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Gjithashtu, kriteri i mësipërm nuk shfaq diskriminim mes operatorëve të cilët blejnë dhe ofertojnë për kryerjen e punimeve e produkt të gatshëm dhe atyre të cilat ofrojnë kryerjen e punimeve me produkte (suva) të prodhuara manualisht me autobetonjere ose procese të njohura, duke kërkuar në rastin konkret repturën përkatëse.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike: janë sipas projektit të zbatimit të hartuar nga projektuesi dhe marrë në dorëzim nga grupi i punës përkatës për marrjen në dorëzim të projektit me dokumentacionin teknik të tij , duke iu përmbajtur parashikimeve të nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Shënim: Në të gjitha rastet në specifikime teknike ose preventiv ku mund të jenë përmendur markë specifike apo emërtim AK ka parashikuar se do të pranohen edhe ekuivalentët e tyre.

Shënim: Në të gjitha rastet ku në Dokumentat e tenderit, specifikimet teknike ose preventiv përmenden standarte ndërkombëtare Ak, ka parashikuar se do të pranohen edhe standartet kombëtare të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA).

NJËSIA E PROKURIMIT